



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2074 prot.

Himarë, më 19.03. 2026

VENDIM

Nr. 6, Datë 11.03. 2026

PËR

**“NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.57, DATË 26/11/2025”
“PËR DISA NDRYSHIME NË “PAKETËN FISKALE TË VITIT 2022”, MIRATUAR
ME VKB NR.54, DATË 25.11.2021, NDRYSHUAR ME VKB NR.34, DATË 03.12.2024”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar), ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, të ndryshuar, VKM-së nr.319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, udhëzimit të Ministrit të Financave nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.57, datë 26/11/2028 “Për disa ndryshime në “Paketën Fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”, dhe duke ju referuar relacionit nr.622prot., datë 23/01/2026 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 11.03.2026, miratoi me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë::

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.57, datë 26/11/2025 “Për disa ndryshime në “Paketën Fiskale të vitit 2022”, miratuar me VKB nr.54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr.34, datë 03.12.2024”, të bëhet ky ndryshim:

Në pikën 3 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Tabela ku paraqitet niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve ndërtimore, ndryshohet si më poshtë:

Emërtimi i kategorisë së ndërtimit ose llojit të objektit të ndërtimit	ZONA A (Dhërmi, Palasë, Ilias, Vuno, Himarë, Q.Pali, Borsh, Lukovë, Piqeras, Nivicë, Shkallë, Shënavasil)	ZONA B (Kudhës, Pilur, Corraj, Ftterrë, Sasaj fshat si dhe ish territori i Komunës së Horë-Vranishtit)
Ndërtime për qëllime; Objekte banimi, administrative, tregtie, shërbimi etj. që kryhen nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për qëllime turizmi, industrie apo përdorimi publik.	8 % e çmimit të shitjes për metër katror	4 % e çmimit të shitjes për metër katror

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6.

NË MUNGESË
ZËVENDËSKRYETARI
Milto Nika




KRYETARI
Dhimitër Kapaj